



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 5 shkurt 2024
Nr. ref.:RK 2318/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI217/22

Parashtrues

Nuri Rexha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [2021:206775] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 20 shtatorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhami Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nuri Rexha, lagija Dushkajë, komuna e Kaqanikut (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Liman Musa, avokat nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykit [2021:206775] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 20 shtatorit 2022, në lidhje me Aktgjykit [CA. nr. 191/2016] të Gjykatës së Apelit të 28 shtatorit 2020 dhe Aktgjykit [C. nr. 228/2014] të Gjykatës Themelore në Kaçanik të 4 dhjetorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kérkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të lartcekura, për të cilët pretendohet se cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kérkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

4. Kérkesa bazohet paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridikioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kérkesës) dhe 47 (Kérkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri ne fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrimit të kérkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruar në Gjykatë përparrë shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 dhjetor 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kérkesës dorëzoi përmes postës kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2022, Gjykata e pranoi dhe e regjistroi kérkesën.
8. Më 11 janar 2023, Kryetarja e Gjykatës me vendimin [nr. GJR. KI217/23] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, dhe me vendimin [nr. KSH. KI217/23] caktoi Kolegjin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha, (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, anëtarë.
9. Më 24 janar 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kérkesës për regjistrimin e kérkesës dhe, në të njëjtën kohë, kerkoi nga ai që të plotësojë formularin standard të kérkesës së Gjykatës, si dhe të dorëzojë në Gjykatë Aktgjykit [CA. nr. 191/2016] të Gjykatës së Apelit.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës Supreme.

11. Më 15 shkurt 2023, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës formularin e Gjykatës të plotësuar vetëm pjesërisht si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, të cilin Gjykata e kërkoi përmes shkresës së 24 janarit 2023.
12. Më 21 janar 2024, Kolegji shqyrtaues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e Gjykatës.

Përbledhja e fakteve të rastit

13. Gjykata, vetëm në bazë të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, të cilat i konteston parashtruesi i kërkesës, dhe jo në bazë të kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, për shkak se nuk ka përshkrim përkatës të fakteve në të, konstaton se parashtruesi i kërkesës dhe personi G.K kanë lidhur një kontratë paraprake për blerjen e lokalit afarist në një sipërfaqe prej 35 m², me çmimin e dakorduar prej 66.000 euro, që është dashur paguhej me këste. Parashtruesi ka paguar këstin e parë në shumën 20 000 euro. Megjithatë, hapësira e zyrës nuk është ndërtuar brenda kornizës kohore të dakorduar.
14. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore, në të cilën G.K., nga Suhareka, paraqitet si i paditur i parë, ndërsa E.B., nga fshati Biçec, komuna e Kaçanikut, paraqitet si i padituri i dytë. Në kërkesëpadi parashtruesi i kërkesës ka këruar anulimin e parakontratës si dhe kthimin e shumës prej 20.000 euro me kamatë të llogaritur.
15. Më 28 tetor 2015, gjatë seancës shqyrtauese në Gjykatën Themelore, i padituri i parë, G.K., nuk e kontestoi padinë e paditësit (parashtruesi i kërkesës) dhe theksoi se nga paditësi (parashtruesi i kërkesës) ka pranuar mjete në vlerë prej 20.000 € për blerjen e lokalit afarist, në sipërfaqe prej 35 m², ndërsa të paditurit të dytë E.B., i ka paguar shumën prej 650€, për detyrimet e kompanisë.
16. I padituri i dytë, E. B., kontestoi kërkesëpadinë e paditësit gjatë seancës gjyqësore dhe i propozoi gjykates që ta refuzojë atë, “*sepse nga të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës u vërtetua se i padituri i parë i ka marrë këto mjete, të cilin fakt ai e ka pranuar.*“
17. Më 4 dhjetor 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [C. nr. 228/14], përmes të cilit pranoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi parakontratën paraprake për shitblerjen e objektit afarist të lidhur më 6 qershor 2009, dhe obligoi të paditurin e parë G.K., që t'ia kthejë parashtruesit të kërkesës shumën prej 20.000 €, me kamatë të llogaritur.
18. Përmes të njëjtë aktgjykim, Gjykata Themelore e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës kundër të paditurit të dytë E. B. si të pabazuar.
19. Në aktgjykim [C. nr. 228/14], Gjykata Themelore theksoi:

[...] gjykata e detyroi të paditurin e parë që të ia përbush detyrimin paditësit, sepse i padituri i parë i ka marrë këto mjete, ndërsa lokalini nuk ia dorëzuar sipas marrëveshjes [...]

Meqenëse i padituri ka rënë në vonësë me kompensimin e dëmit. Gjykata kërkesën e palës paditëse dje në bazë të nenit 277 te LMD-së, e detyroi të paditurin G.K., që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamaten si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar për më shumë se

një vit edhe ate duke filluar nga data 06.06.2009 (nga data kur i janë dorëzuar mjetet financiare, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e refuzoi padinë e paditësit si të pa bazuar ndaj të paditurit Elham Bunjaku, nga fshati Biçec, sepse nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës u vërtetua se shumën e mjeteve prej 20,000.00€, i ka pranuar i padituri G. K., ndërsa ky nuk ka marrë asnë obligim për pagesë, e këtë fakt gjykata e vërtetoi nga aneks kontrata e datës 07.08.2009.”

20. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në lidhje me refuzimin e kërkesëpadisë kundër të paditurit të dytë, duke pretenduar vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
21. Më 28 shtator 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [CA. nr. 191/2016], përmes të cilit refuzoi ankesën e paditësit si të pabazuar, ndërsa vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
22. Në arsyetimin e Aktgjykimit [CA. nr. 191/2016], Gjykata e Apelit theksoi:

„[...] gjendja faktike, ashtu si që është cekur më parë, drejtë dhe në masë të duhur është vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, andaj pretendimet ankimore me të cilat tregohet nëe vertetim të gabuar dhe jo të platë të gjendjes faktike janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë nga kontratat e bashkangjitura, parakontratës dhe provave tjera me shkrim në menyrë të padyshimit verteton se paditësi ka genë në marrëdhënien kontratore, raporti i shitëblerjes së paluajtshmërisë me të paditurin e parë, ndërsa i padituri i dytë ka genë vetëm dëshmitar i punës juridike të cekur, dhe ashtu edhe nënshkrues në parakontratën lëndore. Marrëdhëeniet kontraktuale të paditurit të parë dhe të paditurit të dytë nuk kanë të bëjnë me paditësin, as nuk janë me ndikim në të drejtat e tij.“

“Sipas të cekurave, në kuptim të nenit 45 par. 1,2 dhe 3 të LMD, parakontrata e lidhur krijon obligim për kontraktuesit. Duke marr parasysh se i padituri i parë nuk i ka përbushur obligimet e tij, andaj paditësi sipas nenit 124 të LMD ka pasur të drejtë në shkëputje të kontratës, dhe të drejten në kompensim dëmi.“

23. Parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën Supreme, duke pretenduar „shkelje të procedurës kontestimore, nga nisi 182 paragrafi 1, dhe paragrafi 2, pika k), n) dhe i), për shkak të shkeljeve të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.“
24. Më 20 shtator 2022, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [2021:206775], duke refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit, të paraqitur kundër Aktgjykimit [CA.nr.191/2016] të Gjykatës së Apelit.
25. Në arsyetimin e Aktgjykimit [2021:206775], Gjykata Supreme theksoi:

Nuk qëndron pretendimi se gjykata e shkallës se parë ka bërë shkejje të dispozitave ligjore nga 2 pika i), të LPK-së, pasi që nuk iu ka dhënë mundësinë palëve të dëgjohen në cilësinë e palës në procedure, kjo për faktin se dispozita e lartcekur nuk e obligon gjykatën që të bëjë dëgjimin e palëve në cilësinë e palës në procedurë, por e obligon që t'ia sigurojë mundësinë që në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë të bëjë shqyrtimin e çështjes në gjykatë, gjë të cilën gjykata e shkallës së parë e ka bërë, pasi që e njëjta palët i ka ftuar në

mënyrë të rregullt për seancë, është siguruar nëse ftesa i është dorëzuar palëve në mënyrë të rregullt, dhe në këtë drejtim nuk ka pasur shkelje të procedurave, pasi palët kanë mundur ti parashtrojnë të gjitha pretendimet dhe deklarimet e tyre, që është e mjaftueshme për të siguruar qasje në gjykatë dhe proces i rregullt për gjykim të drejtë dhe në përputhje edhe me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

„Në raport me pretendimet në revizion se "Vendimi i atakuar është i paqartë, kontraditor me aesyetimin e aktgjykimit të atakuar dhe se i njëjtë përmban elemente që shkaktojnë konfuzion dhe paqartësi në të kuptuarit e arsyes së vendosjes", është pretendim i pa themelte, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përbajtje është në përputhje me dispozitat nga neni 160 i LPK-së, ngase dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe arsyetimi i aktgjykimit është në perputhje të plotë me mënyrën e vendosjes.“

„Pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nuk u pranuan si të bazuara nga Gjykata Supreme, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë duke e vlerësuar të njëtin pretendim të paditurit të paraqitur edhe pranë këtyre gjykatave, kanë dhënë arsyetim të plotë, të qartë dhe të njëjtat arsyen janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. pasi në rastin konkret, midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se i padituri i parë G.K. nga Suhareka, ka marre nga paditësi shumën e parave në vlerë prej 20,000.00€, dhe kthimin e këtyre mjeteve e ka pas detyrim për shkak të mos përrnrbushjes së kontratës nga ana e tij. Kjo vërtetohet me para kontratën e lidhur në mes të paditesit dhe të paditurit të parë me datë 06.06.2009.“

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës thekson se vendimet e gjykatave të rregullta cenojnë të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushetutës, si dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
27. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljet e pretenduara të neneve të Kushetutës dhe të KEDNJ-së ekskluzivisht me dy paragrafë, të cilët Gjykata do t'i citojë të plotë:

„CENIM I RËND I Konventës Europiane nenı 6, të drejtat e njeriut, si dhe të drejtave të garantuara në Kushetutën e Republikës së Kosovës për një Gjykim të drejt të barabart para ligjit, bazuar në fakte dhe prova.

Gjykata në çdo fazë procedurës ka detyrim të respektoj dhe ti marrë për bazë gjitha rrethanat dhe provat e prezantuara nga të gjitha palët e jo në mënyrë arbitrale të veproj në mënyrë jo kushtetuese dhe ne kundershtim me Konventen Europiane per te drejtat e njeriut duke filluar nga nenı 1 e deri te dispozita e fundit ku garantohen të drejtat e njeriut para gjykatave, si dhe në kundërshtim me vet Kushetutën e Republikës se Kosovës“.

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata ta aprovoj kërkesën e tij, ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose që Aktgjykimi [C. nr. 228/2014] t'i kthehet Gjykatës Supreme për të nxjerrë aktgjykim të drejtë dhe meritor.

Dispozitat përkatëse të Kushtetutës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gjëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Përveç kritereve të lartcekura, Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kérkesa individuale)

“Cdo individ ka tē drejtë tē kérkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike nē rast se pretendon se tē drejtat dhe liritë e tija individuale tē garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individ mund tē ngrejë kérkesën nē fjalë vetëm pasi që tē ketë shteruar tē gjitha mjetet juridike tē përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kérkesës)

“Parashtruesi i kérkesës ka pér detyrë që nē kérkesën e tij tē qartësojë saktësisht se cilat tē drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik tē cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kérkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon tē ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në tē gjitha rastet e tjera, afati fillon tē ecë nē ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kérkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon tē ecë që nga dita kur ligji ka hyrë nē fuqi.”

32. Sa i përket përbushjes së kritereve tē lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kérkesës është: (i) palë e autorizuar; (ii) konteston një akt tē një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [2021:206775] tē Gjykatës Supreme tē 20 shtatorit 2022; (iii) ka shteruar tē gjitha mjetet juridike nē dispozicion tē tij nē pajtim me ligjin; (iv) ka sqaruar tē drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, nē pajtim me nenin 48 tē Ligjit; si dhe (v) e ka dorëzuar kérkesën nē pajtim me afatet e përcaktuara nē nenin 49 tē Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kérkesës ka përbushur kriteret e pranueshmërisë tē parapara nē rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] tē Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret nē bazë tē së cilave Gjykata mund tē shqyrtojë kérkesën, duke përfshirë kriterin që kérkesa tē mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kérkesën tē papranueshme, nëse kérkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë nē mënyrë tē mjaftueshme pretendimin e tij .”

34. Rregulli i lartcekur, bazuar nē praktikën gjyqësore tē GJEDNJ-së si dhe nē bazë tē praktikës gjyqësore tē Gjykatës, i mundëson kësaj tē fundit që tē shpallë kérkesa tē papranueshme pér arsyen që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar nē këtë rregull, Gjykata mund tē shpallë një kérkesë tē papranueshme nē bazë tē dhe pas vlerësimit tē meritave tē saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përbajta e kérkesës është qartazi e pabazuar nē baza kushtetuese, siç përcaktohet nē paragafin (2) tē rregullit 39 tē Rregullores së punës (shih rastin [K104/21](#), parashtruese [Nexhmiye Makolli](#), aktvendim pér papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [K1175/20](#), parashtruese [Agjencja Kosovare e Provatizimit](#) aktvendim pér papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngérthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*.
36. Në këtë kontekst dhe në tekstin e mëtejmë, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujojë esencën e rastit që ngérthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në rrethanat e këtij rasti konkret, Gjykata rikuhton se ajo e rindërtoi situatën faktike vetëm në bazë të aktgjykimeve të cilat kontestohen nga parashtruesi i kërkesës para kësaj gjykate, për arsy se nuk kishte shpjegim dhe përshkrim të hollësishëm të gjendjes faktike nga kërkesa e paraqitur në gjykatë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës. Në bazë të një rikonstruksioni të tillë të gjendjes faktike, Gjykata arriti në përfundimin se parashtruesi i kërkesës ka lidhur një parakontratë me G.K., me qëllim të ndërtimit të një hapësire afariste me sipërfaqe 35 m², për çmimin e rënë dakord prej 65.000 euro, që duhej të paguhej në fazë. Parashtruesi i kërkesës ka paguar këstin e parë në shumën 20 000 euro. Mirëpo, duke qenë se puna e kontraktuar, përkatësisht ndërtimi i objekteve afariste, nuk është kryer, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesëpadi kundër dy personave, përkatësisht G.K. dhe E.B., me të cilën ka kërkuar anulimin e parakontratës, si dhe kthimin e shumës së të hollave në shumën 20.000 euro, me kamatë vonesë. Gjykatat e rregullta e kanë pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, përkatësisht pjesën që i referohej të paditurit të parë G.K., ndërsa kërkesëpadia lidhur me të paditurin e dytë E.B. është refuzuar nga gjykatat e rregullta si e pabazuar.
38. Sipas konstatimeve të kësaj Gjykate, ishte pikërisht ky fakt që e shtyu parashtruesin e kërkesës që të pretendoj se në procedurat në gjykatat e rregullta ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
39. Megjithatë, sic Gjykata tashmë ka deklaruar dhe do të përsëri së këtu, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka dorëzuar fillimisht me postë "formularin e kërkesës së tij" më 28 dhjetor 2022, të cilin e titulloi si "KËRKESË PËR MBROJTJE TË KUSHTETUTSHMËRISË", në të cilin ka përmendur ekskluzivisht shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të cilën ai u përpoq ta arsyetoj shkurtimisht dhe në mënyrë të paqartë me dy paragrafë dhe që Gjykata tashmë i ka përmendur në tërësi në pjesën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
40. Meqenëse "Kërkesa për mbrojtje të kushtetutshmërisë" e parashtruar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës nuk plotësonte kërkesat procedurale që ajo të shqyrtohej, Gjykata i dërgoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës një shkresë plotësuese përmes së cilës kërkoi, i) të plotësoj formularin standard të kërkesës së gjykatës, dhe ii) t’i dorëzojë Gjykatës aktgjykimin e Gjykatës së Apelit që nuk është dorëzuar në kërkesën e parë.

41. Gjykata duhet të deklarojë se më 15 shkurt 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dërgoi formularin e kërkesës zyrtare të Gjykatës, por aty mungonte plotësish **i)** përshkrimi faktik i rastit dhe **ii)** nuk sqaroi pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. E vetmja gjë që ka dekluar përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, që paraqet ndryshim nga kërkesa e parë, është se në formularin e plotësuar të Gjykatës ai pretendoi shkelje shtesë të neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, përkatësisht neneve 21, 22, 24, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
42. Prandaj, Gjykata konstaton se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, as në kërkesën e tij të parë të datës 28 dhjetor 2022, as në kërkesën e dytë të datës 15 shkurt 2023, nuk ka dhënë një përshkrim kronologjik të fakteve të rastit, asnjë analizë të detajuar lidhur me pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet e përmendura të Kushtetutës ose arsyetime mbi pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës. Përveç kësaj, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka përmendur disa nene të Kushtetutës dhe nuk ka dhënë një përbledhje të fakteve në rastin e tij dhe as nuk ka sqaruar se si procedurat gjyqësore që janë zhvilluar në gjykatat e rregullta, apo më saktë se si akt gjykimet e kontestuara kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara të neneve të Kushtetutës.
43. Përveç kësaj, Gjykata thekson veçanërisht se parashtruesi i kërkesës, në procedurën në Gjykatën Kushtetuese, përfaqësohej nga një avokat, i cili pritet të ketë njohuri në lidhje me kriteret procedurale që duhet të plotësohen gjatë paraqitjes së një kërkese në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me pranueshmërinë e të njëjtës. Për më tepër, ai kishte jo një, por dy mundësi për të ndërtuar rastin për parashtruesin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, gjë që sigurisht nuk e bëri.
44. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të kësaj gjykate, por edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrëthanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së: [*Trofimchuk kundër Ukrainës*](#), nr. [4241/03](#), vendim i od 31 majit 2005; dhe [*Baillard kundër Francës*](#), nr. [6032/04](#), vednim i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrëthana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës: [KI166/20](#), parashtrues [*Ministria e Punës dhe Mirëgenies Sociale*](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
45. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimeve të kontestuara janë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet e sipërpërmendura, por nuk shtjellon më tej se si dhe pse ka ndodhur shkelja e këtyre neneve përkatëse. Në lidhje me atë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se referimi i thjeshtë në nene të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje

kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI175/20](#), Parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52; dhe [KI04/21](#), Parashtruese *Nexhmije Makolli*, cituar më lart, paragrafët 38-39).

46. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës në asnjërin nga pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 21, 22, 24, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së nuk i ka përbushur kërkesat e paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës lidhur me arsyetimin dhe argumentet e hollësishme lidhur me pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës së tij.

Përfundim

47. Në fund, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e neneve 21, 22, 24, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. Prandaj, kërkesa në tërsi deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashikohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) (g) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 janar 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

